



AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SHTYPSHKRONJA MORAVA” SH.P.K.

Ne Tirane, sot me date 20 Gusht 1998 z.AGRON MORAVA banues ne Tirane, me zotesi juridike dhe per te vepruar deklarom ne kete akt themelimi si me poshte :

NENI 1

Ortaku i Vetem AGRON MORAVA ka vendosur per krijimin e shoqerise “ SHTYPSHKRONJA MORAVA” sh.p.k..

NENI 2

Kjo shoqeri me pergjegjei te kufizuar eshte person juridik ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe aktiviteti i saj rregullohet sipas dispozitave te statutit te kesaj shoqerie dhe duke u bazuar edhe ne kete akt themelimi si dy akte baze te kesaj shoqerie.

NENI 3

Selia e kesaj shoqerie do te jete ne Tirane rr.”RR.”Gjon Kastro” me te drejte per te ndryshuar qendren e saj si edhe per te hapur dege dhe filiale te tjera ne te gjithe Republiken e Shqiperise si edhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4

Kapitali fillestar i kesaj shoqerie do te jete i perbere nga nje shume prej 100.000 leke , i cili eshte edhe kontribut i ortakut te vetem te kesaj shoqerie.

NENI 5

Kohezgjatja e kesaj shoqerie do te jete mbi 10 vjet. Kjo shoqeri mund te shperbehet edhe para mbarimit te ketij afati sipas rasteve te parashikuara ne statutit e kesaj shoqerie (shperberja e likuidimi)

NENI 6

Objekti i aktivitetit te kesaj shoqerie do te jete ne fushen : Botime libra, fletore, kartoleri si edhe cfaredo lloj qe ka lidhje me shtypshkrime dhe botime si edhe tregetin e tyre me shumice dhe pakice etj. Kjo shoqeri

ushtron edhe cdo veprimtari tjetër që i shërben rritjes dhe zhvillimit të kesaj shoqërie tregtare.

NENI 7

Fillimin e aktivitetit të saj tregtar kjo shoqëri e lidh me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar të Gjykatës së rrethit të Tiranës si edhe me pajtimin me licencën në Zyrën e Tatimeve.

NENI 8

Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kesaj shoqërie mbrohen nga legjislati shqiptar në fuqi.

NENI 9

Administratori i kesaj shoqërie do të jetë ortak i vetëm i saj z. AGRON MORAVA i cili kontrollon dhe ndjek aktivitetin e kesaj shoqërie duke zbatuar edhe kompetencat perkatese të percaktuara në statutin e kesaj shoqërie.

NENI 10

Për ruajtjen dhe sigurimin e pasurive të saj të luajtshme dhe të paluajtshme kjo shoqëri mund të drejtohet INSIG-ut në qendër dhe deget e tij.

NENI 11


Dispozita me të hollësishme janë parashikuar në statutin e kesaj shoqërie e cila shpreh vullnetin e lirë të themeluesit.

SHOQERIA ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

“SHTYPSHKRONJA MORAVA “ SH.P.K.

ORTAKU I VETËM

Z. AGRON MORAVA



STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SHTYPSHKRONJA MORAVA” SH.P.K.

Ne mbeshtetje te ligjit 7638 date 19.11.1992, une AGRON MORAVA, si themelues i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “SHTYPSHKRONJA MORAVA” sh.p.k., me zotesi te plote juridike per te vepruar deklaroj se

1. FORMIMI I SHOQERISE

NENI 1

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e quajtur “SHTYPSHKRONJA MORAVA” me ortake te saj te vetem z.AGRON MORAVA, banues ne TIRANE.

II. QENDRA E SHOQERISE

NENI 2

Qendra e shoqerise “SHTYPSHKRONJA MORAVA” do te jete ne Tirane, rr.”Gjon Kastrot”. Kjo shoqeri mund ta ndryshoje adresen dhe seline e saj sipas nevojave te saj, si edhe mund te hape vendqendrim te tjera ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise si edhe jashte shtetit ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

III. KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 3

Kohezgjatja e aktivitetit te kesaj shoqerie do te jete mbi mbi 10 vjet . Por ajo mund te shperbehet ne cdo kohe gjithnje me vendim te themeluesave te kesaj shoqerie.

IV. OBJEKTI I AKTIVITETIT TE KESAJ SHOQERIE

NENI 4



Objekti I aktivitetit te kesaj shoqerie do te jete ne fushen e: Botime , libra, fletore, kartoleri si edhe cfaredo lloj qe ka lidhje me shtypshrime dhe botime si edhe tregetin e tyre me shumice dhe pakice.


V. KAPITALI FILLESTAR

NENI 5

Kapitali fillestar I kesaj shoqerie do te perbehet prej 100.000 leke, kapital I cili perbehet nga kontributi i vetem i Ortakut themelues te kesaj shoqerie. Kjo shoqeri me vendim te organit vendimor mund te shtoje kapitalin apo te pakesoje duke shtuar investime te reja, duke i regjistruar keto pjesmarrje ne baze te legjislacionit shqiptar, po keshtu ajo ka te drejte edhe te transferoje kapitalin e saj sipas interesave te shoqerise se krijuar.

VI. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 6



Kjo shoqeri deklarohet e krijuar ne zbatim te legjislacionit shqiptar si edhe ne zbatim te plote me normat qe permban ky statut . Ajo konsiderohet e krijuar dhe merr forme te plote juridike me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar te gjykates se rrethit Tirane si edhe merr fuqi per zhvillimin e aktivitetit te saj ekonomik me marrjen e licences nga zyra e tatimeve te rrethit. Ortaku i vetem e drejton aktivitetin e kesaj shoqerie duke u bazuar ne parimin dhe te drejten e prones private.

NENI 7

Emertimi i kesaj shoqerie do te shoqeroje te gjitha dokumentacionin qe ka lidhje me marredheniet e saj me te tretet.

NENI 8

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar do te kete vulen e saj e cila do te kete forme dhe madhesi te zakonshme dhe me tekstin perreth saj, vule e cila do te shoqeroje te gjitha dokumentacionin e nxjerre nga kjo shoqeri.

NENI 9

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "SHTYPSHKRONJA MORAVA" sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper detyrime



kontraktore dhe jashte kontraktore. Ortaku i kesaj shoqerie drejton te gjithë aktivitetin e saj si edhe te gjithë detyrimet ndaj te treteve.

NENI 10

Gjate zhvillimit te aktivitetit kjo shoqeri administrohet nga ortaket i saj i vetem. ADMINISTRATOR i kesaj shoqerie do te jete z.AGRON MORAVA. Ortaku i Vetem do te jete organi vendimor i kesaj shoqerie. Vendimet e ketij organi qe vijne ne harmoni me dispozitat e ketij statuti dhe me legjislacionin ne fuqi jane te detyrueshme per te gjithë anetaret e kesaj shoqerie.

VI. KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE


NENI 11

Ortaku i vetem gjate kryerjes se aktivitetit te saj do te kete keto kompetenca:

- Te miratoje bilance 3 mujore dhe vjetore te aktivitetit financiar, jo me vone se nje muaj nga bylljet kalendrike.
- Te caktoje rregullin e brendshem te punes.
- Te caktoje e miratoje numrin e punonjesve, pagat e tyre si edhe kushtet e marrjes se tyre ne pune.
- Te analizoje veprimtarine mujore, vjetore si edhe te percaktoje drejtimit e zgjerimit te aktivitetit.
- Te miratoje kontratat e nevojshme per zhvillimin e aktivitetit, veprimtarine financiare me persona fizike apo juridike vendas dhe te huaj.
- Te percaktoje tarifat e sherbimeve, riparimeve, transportit, sipas objektit te aktivitetit te saj.
- Te analizoje dhe miratoje kerkesat per kredi.
- Te miratoje dhe drejtoje komisionin per likujdimin e shoqerise.
- Te kryeje te gjitha veprimet qe kane te bejne me veprimet bankare, hapje llogarie, depozitim dhe terheqje te hollash, celje leter krediti etj.
- Te kryeje te gjitha veprimet likujdime taksore qe kane te bejne me institucione dogane dhe tatimore, etj

NENI 12

Per demet qe i shkaktohen shoqerise per shkak te drejtimit per shkeljen e statutit dhe te aktit te themelimit, ortaku do te pergjigjet gjithnje ne



perputhje me detyrat qe i jane ngarkuar ortakeve ne kete statut per ndjekjen e aktivitetit sipas objektit te veprimtarise.


VII. PERFAQESIMI I SHOQERISE

NENI 13

Ortaku i vetem dhe njekohesisht Administratori, e perfaqeson kete shoqeri ne te gjitha marredheniet me organet shteterore, gjyqesore, financiare e private. Me vendim te Ortakut te vetem te kesaj shoqerie per veprime te ndryshme si edhe per probleme te vecanta gjate aktivitetit te kesaj shoqerie me prokure te Pergjithshme apo te posacme caktohet nje person i cili mund te jete punonjes ose jo ne kete shoqeri per kryerjen e veprimeve te ndryshme te cilat do te jene te parashikuara ne kete prokure.

VIII. ADMINISTRIMI I TE ARDHURAVE TE REALIZUARA.

NENI 14




Per administrimin e te ardhurave gjate aktivitetit te saj do te caktohet nje ekonomist I cili do te kryeje te gjitha veprimet financiare te nevojshme per evidentimin e te ardhurave te realizuara, fitimit te arritur si edhe detyrimeve etj. Ne lidhje me keto. Te ardhurat do te evidentohen ne librat e llogarise me llogarite e saj te vecanta, keshtu konkretisht do te behet llogaritja e te ardhurave te pergjithshme te realizuara, duke u zbritur keshtu tatimi mbi qarkullimin, tatimin fitimin, te gjitha detyrimet qe kjo shoqeri do te kete me shtetin, pagat e punonjesve te punesuar ne kete shoqeri, dhe me pas fitimi I mbetur pas te gjitha ketyre mund te kaloje per zgjerimin dhe shtimin e aktivitetit te kesaj shoqerie. Fusha e kontrollit dhe periudha e kryerjes se tij do te caktohet me vendim te Ortakut te Vetem.

NENI 15

Viti financiar eshte nga 01 Janar deri me 31 Dhjetor . Ortakeve fitimi I realizuar i paguhet me mbylljen e bilancit vjetor. Pagat, kuotat e shperblimeve paguhet me leke.

IX. MARREDHENIET E PUNES

NENI 16




Kjo shoqeri ka te drejte te punesoje ne shoqerine e saj shtetas shqiptare dhe te huaj. Marredheniet e saj me te punesuarit ajo i rregullon me ane te kontratave te punes te cilat mund te jene individuale ose kolektive, gjithnje ne zbatim me legjislacionin shqiptar te punes si edhe te dispozitave te ketij statuti.

NENI 17

Te gjitha mosmarreveshjet e krijuara nga kjo shoqeri, ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim ndermjet paleve punedhene dhe punemarres , kompetente per zgjidhjen e tyre do te behet Gjykata e rrethit ku kjo shoqeri ka seline e saj.

x. SEKRETI AFARIST

NENI 18



Do te quhen sekret afarist per kete shoqeri te gjitha dokumentat dhe aktet e cilesuara si te tilla nga Ortaku i Vetem i kesaj shoqerie. Kete sekret kane detyrimin t'a ruajne te gjithe punonjesit e punesuar ne kete shoqeri.


XI. SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENI 19

Kjo shoqeri e ndryshon aktivitetit dhe menyren e organizimit te saj me ane te shperndarjes, e cila mund te shperndahet vetem ne rast se nuk e ushtron aktivitetin e saj ose ne rast te ndonje force madhore, po keshtu edhe ne formen e likujdimit. Per likujdimin e saj me Vendim te Ortakut te vetem te shoqerise krijohet Komisioni i likujdimit te shoqerise, i cili harton bilancin e likujdimit dhe e paraqet ate perpara Ortakut te vetem. Ne momentin e miratimit te saj (bilanci), Ortaku i Vetem shpall likujdimin e kesaj shoqerie. Pas kesaj shpallje kryhen te gjitha veprimet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Regjistri I Gjykates se rrethit Tirane si edhe ne zyren perkatese te tatimeve.

NENI 20

Me vendim te ortakut te Vetem te kesaj shoqerie mund te behen ndryshime ne objektin e ketij statuti, ne pjesmarrjen e shoqerise, shtesa ne te, te ndryshoje kapitali i saj, kohezgjatja si edhe selia e saj.



DISPOZITA TE PERGJITHSHME



Te gjitha ndryshimet qe do te pasojne ne legjislacionin shqiptar ne lidhje me Shoqerite tregtare te krijuara, po te jete e nevojshme do te pasqyrohen edhe ne dispozitat perkatese te ketij statuti.

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SHTYPSHKRONJA MORAVA “ SH.P.K.

ORTAKU I VETEM

AGRON MORAVA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 4831 REP. NR. 410 KOL.

VERTETIM

Sot, me date 20-08 1998 para meje Noteres se rrethit Tirane u paraqit personalisht AGRON MORAVA, i biri i Kadriut, lindur dhe banues ne Tirane, rr. "S.Kodra" pall.71/1, shk.2, ap.28, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta e tij me nr. in yelur, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar i cili deklaroi se sa me siper, Akti i themelimit dhe Statuti i shoqerise "SHTYPSHKRONJA MORAVA" jane sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe e nenshkroi ne prezencen time rregullisht dhe une Noterja e vertetoj sipas ligjit.



NOTERE
